

15.03.2022  
Ora 11:37

**RENDI I DITËS**

Projektvendim "Për deklarinimin të përfunduar dhe pa vendim përfundimtar të procedurës administrative të shqyrtimit të rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues zotin Elton Xhaferr Ismaili, kandidat për deputet i propozuar nga Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, Qarku Gjirokastrë, në zbatim të ligjit nr. 138/2015".

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**  
1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z. Ilirjan Celibashi**  
2.Stafi KQZ:                                              **Y.Merkaj, M.Koja**
- **Parti Politike:**                                              **PD (M. Logu)**
- **OJQ**                                                                      **KRIK**

**Z. I. Celibashi:** Mirëdita të gjithëve! Në seancën e sotme publike kemi në rend dite tre çështje. Kemi projektvendimin që ka të bëjë me vlerësimin e rezultateve të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për subjektin vetëdeklarues zotin Elton Xhaferr Ismaili, kandidat për deputet i propozuar nga Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, Qarku Gjirokastrë. Projektvendimin që ka të bëjë shqyrtimin administrativ të denoncimit për shkelje të parashikuar në nenin 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, ndaj Bashkisë Durrës dhe projektvendimin "Për shqyrtimin administrativ për shkelje të parashikuar në nenin 91, të Kodit Zgjedhor dhe në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ndaj Bashkisë Rrogozhinë".

Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.15.03.2022*

Atëherë fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues zotin Elton Xhaferr Ismaili, kandidat për deputet i propozuar nga Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, Qarku Gjirokastrë, për zgjedhjet e 25 Prillit 2021. Po zoti sekretar!

**Z. Y. Merkaç:** Referuar neneve 19, pikat 1, e 2, të Kodit Zgjedhor, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për disa subjekte ndër të cilat është edhe “Deputeti i Kuvendit të Shqipërisë”. Në zbatim të këtyre dispozitave, zoti Elton Xhafer Ismaili, kandidat për deputet i listës shumëmemërore të propozuar nga Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, Qarku Gjirokastrë, në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit me numër unik 347. Përpara miratimit të listave të kandidatëve për deputetë për subjektin zgjedhor Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, në bazë të kompetencave të veta, KQZ bëri verifikimin paraprak pasi konstatoi se kandidati nuk është në kushtet e ndalimit, ndërmori hapat e mëposhtme: ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore, e cila informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve se kandidati për deputet, zoti Elton Xhafer Ismaili, nuk ka të regjistruar dënime penale të formës së prerë në sistem, pra nuk është i dënuar. Gjithashtu Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka kërkuar informacion pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, e cila në

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.15.03.2022*

përgjigje të shkresës sonë ka dërguar informacion, se kandidati për deputet zoti Elton Xhafer Ismaili, nuk rezulton të ketë ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 147 datë 16.03.2021, ka miratuar listën shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021.

Duke pasur parasysh shënimet e bëra në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit,

Pyetjes 7, “A është marrë ndonjëherë për ju masa e dëbimit nga një shtet i huaj?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “Po” duke deklaruar se:

-Është dëbuar nga Janina, Greqi, për arsye të mungesës së dokumentacionit, në tetor 2001.

-Është dëbuar nga Athina, Greqi, për arsye të mungesës së dokumentacionit, në mars 2002, i cili deklaroi se në dijeninë e tij është dënuar me gjobë dhe është dëbuar për një periudhë pesë vjeçare.

Pyetjes 8, “A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se 1 muaj?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “Po” duke deklaruar se: Në periudhën shkurt-mars të vitit 2002, ka qëndruar në Athinë, Greqi, për arsye emigracioni. Bazuar në nenin 8, pika 1, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e Integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka vendosur t’ia kalojë rastin për verifikim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, si institucioni kompetent që kryen verifikimin e plotë të deklarimeve të bëra. Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, vendimin “Për miratimin e rezultatit të verifikimit për subjektin z. Elton Xhafer Ismaili”. Prokuroria e Përgjithshme, pas kryerjes së gjithë verifikimeve të mundshme brenda dhe jashtë vendit, i konsideron këto verifikime të

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.15.03.2022*

plota bazuar në përcaktimet e nenit 8, pikat 1 dhe 2, të lidhura me nenin 5 të ligjit nr. 138/2015, ka miratuar rezultatin e verifikimit të subjektit vetëdeklarues zotit Elton Xhafer Ismaili, sipas të cilit konstatohet:

Nuk rezulton të ketë kryer ndryshime në përbërësit e gjendjes civile, të padeklaruara në formular apo të ndryshme nga ato të deklaruara.

Nuk rezulton të jetë i dënuar me vendim të formës së prerë nga ndonjë autoritet gjyqësor shqiptar apo i huaj, për kryerjen e ndonjë vepre penale.

Nuk rezulton të jetë i dënuar me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga ndonjë autoritet gjyqësor shqiptar apo i huaj, për një çështje penale të pazgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Nuk rezulton të ketë qënë në hetim dhe gjykim, nga një autoritet gjyqësor i huaj, për kryerjen e një vepre penale.

Nuk rezulton të ketë qënë i ndaluar apo i arrestuar në flagrancë, nga organet ligjzbatuese për kryerjen e ndonjë vepre penale.


Nuk rezulton të ketë qënë i siguruar me masë shtrënguese të sigurisë personale.

Nuk rezulton të jetë lëshuar ndonjëherë ndaj këtij personi një urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e ndonjë vepre penale.

Rezulton të jetë marrë masa e dëbimit, nga drejtori i Nëndrejtorisë së të Huajve Atiki, në datë 07.04.2002 dhe i regjistruar në listën e të huajve të padëshiruar dhe i rrezikshëm për rendin publik duke qëndruar në vendin grek pa dokumente legjitime.

Rezulton të jetë arrestuar, nga organet ligjzbatuese greke, më 15.03.02, në Athinë, për shkelje të nenit 394 K.P.L.2910/01, "Hyrje dhe qëndrim i të huajve në shtetin Grek. Në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe rezultatit të verifikimit të thelluar, të Prokurorit të Përgjithshëm konstatohet se: Ligji nr. 138/2015 dhe vendimi nr. 17/2016 i Kuvendit, përcaktojnë në mënyrë të qartë dhe të detajuar se subjektet kanë detyrimin ligjor të deklarojnë çdo informacion në lidhje me

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.15.03.2022*

përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, VENDOS:

Të deklaroj të përfunduar procedurën administrative pa vendim përfundimtar për subjektin vetëdeklarues zotin Elton Xhafer Ismaili.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda tridhjetë ditëve nga hyrja e tij në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Vendimi nr. 137**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



15.03.2022  
Ora 11:46

**RENDI I DITËS**

Projektvendim “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit për shkelje të parashikuar në nenin 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ndaj Bashkisë Durrës”.

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z. Ilirjan Celibashi**
  - 2.Stafi KQZ:      **Y. Merkaj, M. Koja**
- **Parti Politike:**      **PD (M. Logu)**
- **Bashkia Durrës:**      **(A. Isaku)**
- **OJQ**      **KRIK**

**Z. I. Celibashi:** Mirë atëherë vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin administrative, bazuar në denoncimin e Partisë Demokratike dhe Lëvizjes Socialiste për Integrim ndaj Bashkisë Durrës. Përfaqësuesi i Partisë Demokratike është këtu, përfaqësuesi i Lëvizjes Socialiste për Integrim nuk është, përfaqësues nga Bashkia Durrës? Po, ju lutem prezantohuni!

**Z. A. Isaku, përfaqësues i Bashkisë Durrës:** Arben Isaku, drejtor i Drejtorisë Ligjore pranë Bashkisë Durrës, përfaqësues me autorizim.

**Z. I. Celibashi:** E keni dhe autorizimin?

Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 15.03.2022*

**Z. A. Isaku, përfaqësues i Bashkisë Durrës: Po!**

**Z. I. Celibashi:** Mirë, shkurtimisht një relativ nga ana e administratës në lidhje me këtë, pastaj fjalën përfaqësuesit të Partisë Demokratike dhe pastaj përfaqësuesit të bashkisë.

**Z. Y. Merhaj:** Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve gjatë mbledhjes së datës 2 shkurt 2022 është raportuar një denoncim nga subjekti zgjedhor Partia Demokratike dhe Lëvizja Socialiste për Integrim ku pretendohet se Bashkia Durrës ka miratuar vendime për miratimin e listave për 526 familje që përfitojnë nga programi i procesit të rindërtimit për ndërtesat e dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019, që variojnë nga 100 mijë deri në 500 mijë lekë. Ka dyshime të arsyeshme se këto grante, fonde janë përdorur për qëllime elektorale dhe zgjedhore, për shkak se po shpërndahen në prag të zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie, të datës 6 mars 2022. Sipas denoncuesve aktet e miratuara nga ana e Bashkisë Durrës bien në kundërshti me vendimin nr. 9, të vitit 2020 të Komisionit Rregullator, si dhe dispozitave të parashikuara të Kodit Zgjedhor. Sipas parashikimeve të nenit 19, pika 1 të Kodit Zgjedhor, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencën të kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime sipas ligjit, monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së, apo subjekteve të kontraktuara...

**Z. I. Celibashi:** Jo, shkurtimisht! Mbasi është paraqitur denoncimi çfarë veprimesh janë kryer, kaq!

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 15.03.2022*

**Z. Y. Merkaj:** Atëherë nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve i është kërkuar informacion Bashkisë Durrës, për informacion në lidhje me këtë denoncim dhe nga ana e Bashkisë Durrës është kthyer përgjigje, në datën 09.02.2022, ku pretendohet se Këshilli i Ministrave nëpërmjet vendimit nr. 750...

**Z. I. Celibashi:** Përgjigja e Bashkisë Durrës u është bërë me dije palëve denoncuese? Përfaqësuesi i Partisë Demokratike ka marrë dijeni për këtë? Po! Ka marrë!

**Z. I. Celibashi:** Tjetër, veprime të tjera administrative, ose proceduriale kemi bërë?

**Z. Y. Merkaj:** Në përgjigje të kërkesës së KQZ-së Bashkia Durrës ka sjellë njoftimin e sekretarit të Këshillit Bashkiak për kthimin e mbledhjes së datës 28 janar 2022. Ka sjell dhe aktet e mbledhjes që u janë vënë në dispozicion anëtarëve të Këshillit të Bashkisë Durrës, si dhe procesverbalin e mbledhjes së datës 28 janar 2022, dhe vendimet nr. 2, 4, 11 dhe 12 të datës 28 janar 2022 të Këshillit të Bashkisë Durrës. Nga një analizë ligjore që u bëhet këtyre vendimeve duke lexuar dhe nenin 91 të Kodit Zgjedhor ku parashikohet se 4 muaj para datës së zgjedhjeve, deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve ndalohet propozimi, miratimi ose nxjerrja e akteve ligjore, nënligjore, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë. Në qoftë se lexojmë nenin 91, pika 4 të Kodit Zgjedhor deri në formimin e qeverisë së re...

**Z. I. Celibashi:** Mirë, përfaqësuesi i Partisë Demokratike, fjala është për ju!

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*






*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 15.03.2022*

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Faleminderit zoti Celibashi! Së pari gjej rastin dhe t'ju falenderoj për mirëkuptimin e treguar nga ana juaj që kjo seancë mos të zhvillohej në kushtet kur ishim në një periudhë shumë të ngarkuar, edhe për shkak të procesit zgjedhor të 6 marsit, por edhe për shkak të një angazhimi tjetër, në të cilin unë personalisht kam qenë i përfshirë, por sigurisht dhe Partia Demokratike, që ka të bëjë me hetimin parlamentar për inceneratorët, që kam pasur mundësi t'ju informoj dhe zyrtarisht, si përfaqësues i Partisë Demokratike. Një pjesë e fakteve të asaj që tashmë ka ndodhur u relatuan. Megjithatë unë vlerësoj që janë të nevojshme për të kuptuar sesi kemi ardhur, veprim pas veprimi në këtë hetim administrativ, që sigurisht mbështetet në Kodin Zgjedhor, por edhe në vendimin nr. 9, datë 9 mars 2021 të Komisionit Rregullator, që ka të bëjë me kryerjen e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimeve që merren në përfundim të tyre. Kështu ne zoti Komisioner, kishim siguruar nga mediat, nga burimet publike një informacion që Bashkia Durrës, Këshilli Bashkiak i Bashkisë Durrës në prag të procesit zgjedhor të 6 marsit, ose në një kohë shumë të shkurtër pasi zgjedhjet ishin dekretuar nga Presidenti i Republikës, kishte marrë një vendim për të shpërndarë, ose për të përcaktuar apo miratuar listën me 526 familje që përfitonin fonde nga granti i rindërtimit. Në artikull thuhej se shifrat varionin nga 100 mijë deri në 500 mijë lekë dhe sigurisht kishte dyshime të arsyeshme që këto fonde do përdreshin për qëllime elektorale dhe zgjedhore, sepse duhet të kemi parasysh kontekstin në të cilin vinte ky denoncim. Bashkia Durrës në vitin 2021 vetëm një javë përpara zgjedhjeve kishte shpërndarë rreth 6 milionë euro grante, fonde për rindërtimin direkt në llogaritë e qytetarëve të kësaj bashkie. Sigurisht Partia Demokratike, përfaqësuesit e saj nuk kanë asgjë kundër ndihmës që ofrojnë institucionet shtetërore, në këtë rast Bashkia Durrës, për ata qytetarë, për ato familje fatkeqe të cilat janë prekur nga pasojat e tërmetit të 26 nëntorit 2019. Thënë këtë, sigurisht që nuk mund kurrsesi të pranojmë,


*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 15.03.2022*

të lejojmë, apo të mbyllim sytë, që fondet e rindërtimit, që në fund të fundit nuk është Emirjana Sako, as Edi Rama, as Ardian Çela, as Vangjush Dako që po i nxjerr nga xhepi i tij dhe po ua jep qytetarëve, por është buxheti i shtetit, paratë e taksapaguesve shqiptarë, të cilat shkojnë në ndihmë të këtyre familjeve që u prekën nga një fatkeqësi natyrore. Kështu që hetimi administrativ do fillonte me një kërkesë të bërë nga ana jonë, në datën 2 shkurt dhe më pas me një kërkesë për informacion që Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve i drejtonte Bashkisë Durrës. Në fakt në përgjigje të kësaj shkrese, e cila na është përcjellë ne në datën 14 shkurt 2022, Bashkia Durrës ka pranuar që “po, është e vërtetë që në mbledhjen e datës 28 janar 2022, Këshilli Bashkiak i Bashkisë Durrës, me vendimin nr.11” dhe citoj “ky vendim mban numrin 11 dhe nëpërmjet këtij vendimi Këshilli Bashkiak Durrës ka përcjellë në fazën e parë 526 subjektet aplikuese, të cilat kërkojnë rehabilitimin e banesave të dëmtuara nga pasojat e fatkeqësisë natyrore të tërmetit të datës 26 nëntor 2019”. Pra kjo shkresë, e cila bashkëlidhur ka më pas edhe katër vendime që janë marrë në datën 28 janar dhe kryesisht kanë të bëjnë me rehabilitimin e pasojave të shkaktuara nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019, ka konfirmuar, ka pranuar se “po, është e vërtetë” që në datën 28 janar, 8 ditë pasi President i Republikës dekretoi zgjedhjet, 35 ditë përpara zgjedhjeve të 6 marsit, Këshilli Bashkiak i Bashkisë Durrës u mbledh dhe vendosi të miratojë listën e familjeve që përfitojnë nga grantet e rindërtimit. Sigurisht që në këtë shkresë ka pretendime të caktuara që kanë të bëjnë me faktin se kur është lajmëruar mbledhja e Këshillit Bashkiak. Pra, Bashkia Durrës, e cila natyrshëm disponon më shumë informacione sesa disponojnë partitë politike, apo dispononte në atë kohë Partia Demokratike, pretendon që Këshilli Bashkiak është thirrur në datën 13 janar nëpërmjet adresës elektronike e-mail. Kjo është arsyeja, i nderuar zoti Komisioner, që ne sërish, në funksion të kryerjes së një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm kërkuam që të na vihen në dispozicion njoftimi i

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 15.03.2022*

sekretariatit i Këshillit Bashkiak për mbledhjen, aktet e mbledhjes që u janë vënë në dispozicion anëtarëve, procesverbalin e mbledhjes dhe vendimmarrje të cilat lidheshin me rehabilitimin e pasojave të tërmetit të nëntorit 2019. Këto shkresa dhe krahas kësaj dhe një informacion tjetër shumë i rëndësishëm në vlerësimin tonë që kishte të bënte me faktin që nga këto 526 familje përfituese, sa ishin anëtarët e këtyre familjeve të cilët në datën e zgjedhjeve do kishin të drejtën e votimit? Në fakt lidhur me këtë shkresë ne nuk kemi marrë përgjigje. Nuk kemi marrë përgjigje sepse na është kthyer një përgjigje që na thotë se në datën 6 mars do ketë nga këto 526 familje ka vetëm 13 anëtarë të cilët fitojnë të drejtën për herë të parë për të votuar, por ne nuk kemi pyetur për votuesit për herë të parë. Besoj kërkesa ka qenë shumë e qartë se ka dhe një shpjegim. Interesi ynë nuk ka qenë për të ditur kush voton për herë të parë. Interesi ynë ka qenë për të ditur, janë 526 familje përfituese, sa anëtarë ka secila prej këtyre familjeve, përjashtuar fëmijët, pra, ata që janë mbi 18, të cilët kanë të drejtën e votimit, sepse kemi dashur të kuptojmë këto përfitime, vetëm 35 ditë përpara datës së zgjedhjeve, sa zgjedhës potencialisht afektojnë? Se kjo merret me prezumim që afektohen, se pastaj afektohen apo jo, kjo mbetet në vlerësimin e gjithsecilit, dhe në fakt do doja të sillja në vëmendje, zoti Komisioner, që ne nuk mund të përfundojmë sot hetimin administrativ përpara se ky informacion, të cilin ju vetë keni kërkuar me shkresën me numër proptokolli 882, datë 14.02.2022 të administrohet i plotë, ashtu siç është kërkuar dhe jo të administrohet një informacion i paplotë dhe trajtohet administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve sikur nuk ia ka idenë se çfarë po kërkon. Besoj dhe relatimi, edhe përmbajtja, edhe arsyetimi i shkresës është shumë i qartë se çfarë po i kërkohet Bashkisë Durrës. Po e përsëris këtë gjë se kjo është një përpjekje e përsëritur e Bashkisë Durrës për ta trajtuar qoftë këtë hetim administrativ, por qoftë ndoshta dhe ata që e kanë iniciuar këtë hetim administrativ, si njerëz që nuk kuptojnë, nuk dinë, nuk lexojnë dhe ngelen vetëm në

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 15.03.2022*

kuadrin e atyre që thotë bashkia. Dhe na ka ardhur një dokumentacion voluminoz, i cili na është përcjellë për njohje në datën 24 shkurt 2022, të cilin, zoti Komisioner, ne kemi marrë gjithë kohën e nevojshme për ta parë dhe shqyrtuar me shumë vëmendje dhe me shumë kujdes për të kuptuar në fakt se çfarë kishte ndodhur vërtet në mbledhjen e datës 28 janar 2022 dhe në qoftë se pretendimet që ngrinte Bashkia Durrës ishin ashtu siç ata pretendonin, apo ka një të vërtetë paksa më të ndryshme. Unë dua të ndalem lidhur me disa pretendime që janë ngritur nga ana e bashkisë. Ka një pretendim të Bashkisë Durrës që në fakt rendi i ditës është njoftuar në datën 13 janar, dhe në datën 13 janar, thotë Bashkia Durrës, nuk ishte shpallur akoma data e zgjedhjeve të 6 marsit 2022, kështu që ne s’kishim sesi ta dinim që 7 ditë më pas Presidenti i Republikës do të dekretonte zgjedhjet. Por çfarë thotë njoftimi i datës 13 janar? Thotë vetëm këtë gjë, po e citoj, thotë: “Kryesia e Këshillit Bashkiak ka vendosur që mbledhja e radhës do mbahet më datë 28 janar, ora 12:00”, *deadline* për paraqitjen dhe dorëzimin e materialeve nga drejtoritë përkatëse pranë protokollit do jetë data 21 janar 2022, ora 15:00, për projektvendimin dhe relacionin për t’u futur në rend dite. Pra, në datën 13 janar është e vërtetë që është njoftuar mbledhja e radhës, por nuk është njoftuar asgjë se çfarë do shqyrtohet në këtë mbledhje. Madje në vetë e-mail-in e dërguar nga sekretarja e këshillit bashkiak thuhet që materialet do t’jua vëmë në dispozicion pasi të na i sjellë administrata pas datës 21 janar, që përkon me një ditë pas dekretimit të zgjedhjeve. Ky lloj njoftimi në këtë formë është dhe në kundërshti me ligjin. Sigurisht nuk është Komisioneri Shtetëror autoriteti për të vlerësuar shkeljet e ligjit për vetëqeverisjen vendore 139/2015, por megjithatë shërben ndoshta për të kuptuar atë që ne do duam të arrijmë bashkërisht në konkluzion. Në nenin 53 të ligjit 139/2015 për vetëqeverisjen vendore, thuhet: “Thirrja për mbledhjen e këshillit bëhet nga kryetari i këshillit dhe njoftimi bëhet si rregull jo më pak se pesë ditë përpara datës së zhvillimit të saj. Njoftimi përmban


*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 15.03.2022*

datën e mbledhjes, orën, vendin dhe rendin e ditës”. Pra, kur njoftohet një mbledhje e këshillit bashkiak, thotë ligji, duhet të njoftohet edhe rendi i ditës, çka në fakt nga vetë dokumentacioni që na ka përcjellë Bashkia Durrës nuk rezulton që asnjë prej anëtarëve të këshillit bashkiak të jetë njoftuar për rendin e ditës. Ky parashikim është jo vetëm në ligj, por është edhe në rregulloren e funksionimit të Këshillit Bashkiak të Durrësit, të cilin ne e kemi gjetur dhe e kemi shkarkuar nga faqja zyrtare e Bashkisë Durrës. Konkretisht nenet 49, pika 3, tek neni 55, pika 1 dhe 2, parashikojnë qartazi që kur njoftohet mbledhja e radhës e këshillit bashkiak, duhet t’i njoftosh rendin e ditës dhe të gjitha projektaktet që do shqyrtohen në atë mbledhje. Besoj zoti Komisioner, ju me një eksperiencë shumë të gjatë, unë me një eksperiencë më modeste, kjo është një praktikë normale në çdo institucion. Kur njoftohet një mbledhje, njoftohet rendi i ditës dhe bashkëlidhur janë edhe projektaktet që do shqyrtohen, në mënyrë që kushdo që do marrë pjesë në atë mbledhje të jetë fare i qartë. Pra, këtu bie pretendimi i parë se mbledhja dhe vendimet e saj na qënkërkan njoftuar që në datën 13, kur akoma nuk ishte dekretuar data e zgjedhjeve. E vërteta është ndryshe, dhe për këtë gjë nuk ka pasur nevojë që të investigohem shumë, sepse mjafton po themi që të jesh i kujdesshëm dhe të shohësh me vëmendje faqen zyrtare të vetë Bashkisë Durrës. Çfarë ka në këtë faqe? Në faqen zyrtare të Bashkisë Durrës është njoftuar, njoftim për rendin e ditës thotë, të mbledhjes së radhës për ditën e premte, datë 28 janar 2022, ora 12:00, dhe kjo është publikuar, sepse fatmirësisht *ëeb*-i jep dhe datën e publikimit, është publikuar në datën 24 janar 2022. Pra, është publikuar vetëm katër ditë përpara zhvillimit të mbledhjes, dhe katër ditë pasi ishin dekretuar zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 mars, dhe ky njoftim përmban në fakt disa projektakte që kërkojnë të miratohen nga këshilli bashkiak. Por në fakt, zoti Komisioner, ai që bën edhe më flagrante është që në këtë rend dite të njoftuar nuk është vendimi nr. 11, projektvendimi po themi, që më pas do bëhej vendim. Pra, nuk

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 15.03.2022*

është futur fare në këtë rend dite, në rendin e ditës të datës 24 janar. Ku është futur? Është futur në shtesë, që është publikuar në datën 26 janar. Pra, dy ditë përpara zhvillimit të mbledhjes këshilli bashkiak njofton qytetarët dhe anëtarët se do bëjë një shtesë në rendin e ditës me pikën 10 ku është pikërisht “për miratimin e dhënies së ndihmës financiare sipas listës së 13, me subjekte përfitues të programit të grantit për rikonstrukcionin e banesave të dëmtuara si pasojë e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”. Pra, kjo pikë e rendit të ditës nuk është njoftuar as në datën 13, as në datën 24, por vetëm në datën 26, gjashtë ditë pasi ishte dekretuar data e zgjedhjeve, vetëm dy ditë përpara zhvillimit të mbledhjes së këshillit bashkiak, fakt në shkelje edhe të vetë rregullores së këshillit bashkiak dhe në shkelje dhe të ligjit që kërkon që rendi i ditës, projektvendimet t’i vihen në dispozicion anëtarëve pesë ditë përpara zhvillimit të mbledhjes. Kushdo tashmë në mënyrë krejt të arsyeshme mund të ngrejë pyetjen se çfarë është gjithë ky nxitim i Këshillit Bashkiak Durrës për të kaluar këtë vendim qoftë edhe në shkelje të rregullave, procedurave që ligji dhe rregullorja i diktonte këshillit bashkiak për respektimin e afateve. Sigurisht që në këtë afat, në këtë periudhë kohore ndërmjet datës 24, kur është njoftuar rendi i parë i ditës dhe datës 26 kur bëhet shtesa nuk ka ndodhur asgjë tjetër përveçse jemi në kontekstin e zgjedhjeve të pjesshme vendore të datës 6 mars. Qëllimi, pra është shumë i qartë dhe jemi këtu, po të lexoni dhe relacionin e këtij projektvendimi, i nderuar, do të kuptoni që po flasim për aplikime që janë bërë që në fillim të vitit 2020. Pra, ishte 2020-ta, ishte viti 2021 dhe krejt papritur megjithëse ka dy vite që nuk nxitohen për t’u dhënë grantet e rindërtimit këtyre familjeve, krejt papritur në disa ditë përpara zhvillimit të zgjedhjeve të 6 marsit, të gjitha veprimet kryhen në një mënyrë të shpejtë, etj, etj, dhe këto fakte të rëndësishme Bashkia Durrës kërkon t’ia fshehë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Nuk i thuhet për asnjë moment Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve,

*Zbardhi materialin audio*


*Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 15.03.2022*

zoti Komisioner, në rendin e ditës të datës 13 ne nuk kishim njoftuar projektakte, nuk kishim njoftuar rendin e ditës, njoftuam një rend dite në datë 24, në rendin e ditës të datës 24 nuk ishte ky vendim për miratimin e listës së 526 familjeve, por e futëm si shtesë vetëm dy ditë përpara zhvillimit të mbledhjes së këshillit bashkiak. Fatmirësisht, i nderuar, që kemi rënë në dispozicion të këtij dokumentacioni, sepse na ka rezultuar që në atë ditë nuk janë miratuar vetëm vendime që kanë të bëjnë me familjet përfituese të granteve të rindërtimit. Jo! Në të njëjtën ditë është miratuar dhe një vendim tjetër, për dhënien e ndihmës ekonomike të 89 familjeve. Është miratuar dhe një vendim tjetër që ka të bëjë me ndryshimin e një vendimi për dhënien e bursave. Janë dhënë nja 13 bursa në mos gabofsha. Pra, në datën 28 janar Këshilli Bashkiak Durrës kujtohet krejt papritur të shpërndajë grante për rindërtimin për 526 familje, ndihmën ekonomike për 89 familje dhe bursa studimi për 13 nxënës dhe studentë. Nuk kemi asgjë kundër dhënies së këtyre përfitimeve, por qartazi, është e qartë pra, kuptohet pse janë dhënë të gjitha këto përfitime në mbledhjen e datës 28 janar. Ndërkohë që ishim absolutisht, megjithëse fushata zyrtarisht ka nisur në datën 19 shkurt, ishim në kontekstin e zgjedhjeve të pjesshme vendore, të datës 6 Mars 2022, dhe për këtë në fakt mjafton të shqyrtohen aktet që kanë të bëjnë qoftë me dhënien e bursave, që kanë të bëjnë, qoftë me dhënien e ndihmës ekonomike. Prandaj, i nderuar kërkojmë një zgjerim të objektit të kallëzimit. Në objektin e kallëzimit të paraqitur nga Partia Demokratike të shtohet edhe fakti që në mbledhjen e datës 28 janar Bashkia Durrës ka akorduar edhe ndihma ekonomike, edhe bursa studentësh, edhe grante për rindërtimin. Tani unë e kuptoj që grantet për rindërtimin mbase bashkia do fillojë të thotë që tërmeti, kushtet e emergjencës, etj, etj. Po bursat e studentëve, po ndihma ekonomike? Kjo më duket qartazi, në vlerësimin tonë që janë për qëllime të pastra zgjedhore, se nuk ka as në relacion, as në dokumente që janë paraqitur shtesë ndonjë arsyetim, apo argumentim se pse të gjitha këto vendimmarrje


*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 15.03.2022*

po jepen në këtë datë të caktuar. Ka një pretendim tjetër, i nderuar zoti Komisioner, që lidhet me faktin se kur fillon afati? Se Bashkia Durrës thotë që ne lexuam ligjin, lexuam dhe aktet nënligjore të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, meqenëse kishim sipas kuptimit që ata i bëjnë ligjit, meqenëse detyrimet tona, ndalimet tona fillonin në datën 31 janar, ne nxituam që t'i bënim të gjitha në datë 28, në mënyrë që të ishim në rregull me ligjin. Edhe kjo në vlerësimin tone, kur shikohen, vlerësohen dispozitat ligjore në tërësinë e tyre, nuk duhet kaluar kaq thjesht, vlerësojmë ne, nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Dhe çfarë ndodh, çfarë thotë, po themi, neni 91, pika 4, sa u përket akteve ligjore ose nënligjore, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë? “Katër muaj para datës së zgjedhjeve dhe formimit të qeverisë së re pas zgjedhjeve ndalohet propozimi, miratimi, ose nxjerrja e akteve ligjore ose nënligjore, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si akte që parashikojnë rritjen e pagave, pensioneve, mbështetjes ekonomike, apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, vendosja e amnistive, privatizimin apo dhënien e pasurive e të shpërblimeve”, etj, etj. Pra, lë një hapësirë që në këtë listë të shtohen dhe akte të tjera ligjore, nënligjore që parashikojnë dhënien e përfitimeve të caktuara. I njëjti parashikim sigurisht është edhe në nenin 3, pika 3 e vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator. Nga ana tjetër, po është e vërtetë që në datën 22 janar 2022, Komisioni Rregullator ka marrë një vendim sipas të cilit thotë: “Bashkitë në të cilat do kryhen zgjedhjet e pjesshme dhe institucionet e tyre të varësisë janë të detyruara të raportojnë në KQZ të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikohen të zhvillohen në periudhën 31 janar 2022 deri në datën 6 mars 2022”. Pra, qartazi ka një rregullim që lidhet me veprimtaritë publike, të cilat eventualisht në qoftë se shkelin dispozitat ligjore mund të jenë të ndaluara, që fillon nga data 31 janar. Por kjo po të shikohet dhe të lexohet në harmoni, Kodi Zgjedhor, neni 92,

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 15.03.2022*

vendimi nr. 9/2020 i Komisionit Rregullator dhe ky vendim nr. 2/2022 i Komisionit Rregullator u referohet veprimtarive. Nuk ka rregullim të shprehur, apo të nënkuptuar përveçse si e kupton Bashkia Durrës, sa i përket faktit se kur fillojnë ndalimet për nxjerrjen e akteve ligjore ose nënligjore që parashikojnë përfitime për kategori të caktuara të popullsisë. Kështu që përsa kohë nuk ka, ne do t'i referohemi afatit të përgjithshëm. Sigurisht që ligji nuk mund të zbatohet në boshllëk dhe duhet të ndjekë një logjikë të caktuar dhe ne vlerësojmë, i nderuar, që nga momenti që është dekretuar data e zgjedhjeve, se nuk mund të themi që bashkia kishte detyrimin për të mos nxjerrë akte që përfitojnë kategori të caktuara të shoqërisë, se më përpara datës së shpalljes së zgjedhjeve, se pastaj, po themi, do të ishim... përpara se ta dinte që do shpallej data e zgjedhjeve, se pastaj do kalohej në arbitraritet, por të paktën në vlerësimin tone, si duhet respektuar dhe zbatuar ligji, është që nga data 20 janar kur është dekretuar data e zgjedhjeve nga Presidenti i Republikës deri në datën 6 mars 2022, kur janë zhvilluar zgjedhjet e pjesshme vendore është periudhë ndalimi sa i përket nxjerrjes së akteve ligjore ose nënligjore që sjellin përfitime për kategori të caktuara shoqërore. E në këtë kuptim, vendimet e Këshillit Bashkiak Durrës që parashikojnë përfitime për familjet, për 526 familje të prekura nga pasojat e tërmetit të vitit 2019, për 89 familje që përfshihen në skemën e ndihmës ekonomike dhe për 13 nxënës dhe studentë që përfitojnë bursa studimi, hyjnë në kategoritë e atyre akteve ligjore dhe nënligjore që legjislatori ka synuar të ndalojë në mënyrë që ato të mos bëhen objekt përfitimi elektorale nga subjekte apo kandidatë të caktuar të subjekteve zgjedhore. Në rastin konkret është e qartë se kush ishte subjekti që po përfitonte. Kujtoj këtu që projektvendimet e miratuara në mbledhjen e datës 28 janar kanë ardhur me propozim të zëvendëskryetares së bashkisë, asokohe në detyrë si kryetare e bashkisë, kandidatë e Partisë Socialiste për kryetare e Bashkisë Durrës. Pra, kryetarja e Bashkisë Durrës shfrytëzonte funksionin e saj duke qenë

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 15.03.2022*

njëkohësisht dhe kandidate, në mënyrë që për kategori të caktuara shoqërore të ofronte përfitime të drejtpërdrejta në vlera monetare. Ka dhe një fakt tjetër të rëndësishëm, zoti Komisioner, të cilin do doja që të shtohet në objektin e kallëzimit që ne kemi paraqitur, që ka të bëjë me faktin se le ta marrim të mirëqenë për një moment pretendimin se afati i ndalimeve fillonte në datën 31 janar, por rezulton që në faqen zyrtare të Bashkisë Durrës, të cilin pata rastin meqenëse isha duke studiuar akte të sjella nga vetë bashkia, ta shoh me vëmendje, është njoftuar në datën 19 shkurt 2022 një mbledhje e datës 25 shkurt 2022, e orës 12:00, që ka dy pika në rendin e ditës, një prej të cilave thotë: “Për miratimin e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar që përbën ndihmën ekonomike deri 6% e fondit nga të ardhurat e bashkisë, për muajin shkurt 2022”. Kjo mbledhje është zhvilluar në datën 25 shkurt dhe me vendimin nr 13, datë 25 shkurt 2022 janë miratuar. “Miratimin e përfitimit të ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë Durrës për 90 familje”, thotë pika 1. Pika 3. “Miratimin e futjes në skemën e ndihmës ekonomike për muajin janar 2022 të 6 familjeve”. Pika 5 thotë: “Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi 6% i fondit të kushtëzuar 20 familje në një fond të caktuar dhe janë renditur dhe emrat e familjeve. Pra, ky vendim i marrë në kulmin e fushatës zgjedhore, në datën 25 shkurt 2022, nga ana e Këshillit Bashkiak Durrës që ka përfshirë 90 familje. Pra u miraton përfitimin e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e bashkisë 90 familjeve, qartazi dhe përtej çdo lloj diskutimi që mund të zhvillojmë këtu, vjen në kundërshtim me nenin 91, pika 4 të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator. Edhe sikur ta marrim që afati i ndalimeve kishte filluar në 31 janar, jemi në datën 25 shkurt, jemi 8 ditë përpara datës së zgjedhjeve, dhe Bashkia Durrës miraton në pikën e parë 90 familje, në pikën e tretë 6 familje, dhe në pikën e pestë 20 familje. 116 familje ose rihyjnë ose futen për herë të parë, u miratohet dhënia e ndihmës ekonomike. Këtë do ta depozitojmë

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 15.03.2022*

si provë shtesë, zoti Komisioner, së bashku me rendin e ditës përkatës, i njoftuar në datën 19.02.2022 që më pas ka datën vetë. Se ato të mëparshmet nuk përmbanin datë, i kishin lënë pa datë se nuk donin që ndoshta të kuptohej se kur ishin publikuar, nuk e di. Për të kuptuar që në fakt ka pasur një veprimtari të koordinuar të Këshillit Bashkiak Durrës së bashku me kandidaten e Partisë Socialiste, asokohe kryetare në detyrë e Bashkisë Durrës në mënyrë që fondet publike, fondet për tërmetin, fondet për bursat shtetërore, fondet për ndihmën ekonomike të përdroreshin në fushatë zgjedhore, dhe unë dua të depozitoj në cilësinë e provës. Pata mundësi që të shkëpus vetëm tre postime të zonjës Sako, nga rrjeti i saj social *facebook*. Por, duam të kuptojmë se pse bëheshin këto dhënie përfitimesh, grantesh, etj, etj. Dhe po ta shikoni i nderuar zoti Komisioner, mbi 50% e postimeve të zonjës Sako kanë të bëjnë pikërisht me procesin e rindërtimit. “Përfundon lagje e re e Manës, vazhdojmë me të tjera projekte të rëndësishme. Ka përfunduar dhe lagjja e re me 230 apartamente, krahas 236 banesave individuale për familjet e prekura nga tërmeti në këtë zonë, të cilat do të marrin çelësat në dorë ditë pas dite”, postimi i datës 3 mars, Ilirjana Sako. “Rindërtimi nuk është propaganda, por punë dhe fakte dhe Manza është fakti i këtij procesi, nga i cili po merr një hov të rëndësishëm zhvillimi, po kështu do të ketë 140 banesa individuale, kanë përfunduar 102 familje kanë përfituar grantin”, etj, etj, Emirjana Sako, postimi i datës 25 shkurt. Në datën 23 shkurt: “Me programin e rindërtimit kanë përfituar 6 mijë familje, 265 banesa individuale, 297 familje kanë përfituar grante për ndërtimin e banesave dhe 35 shtëpive individuale me shkallë dëmi DS4 janë në proces riforcimi”. Pra, kuptohet qartazi, i nderuar, që procesi i rindërtimit megjithëse është një proces që nuk i përket as kryetares së bashkisë, në kuptimin që nuk është kryetarja e bashkisë që po nxjerr paratë nga xhepi i saj dhe as anëtarët e Këshillit Bashkiak Durrës dhe as ndonjë zyrtar tjetër i kësaj bashkie. Është qartazi duke u përdorur në fushatë për qëllime elektorale. Në këtë kuptim zoti

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 15.03.2022*

Komisioner, unë do të depozitoj si provë shtesë pranë Komisionerit Shtetëror procesverbalin, njoftimin për rendin e ditës të datës 28 janar, njoftimin e parë i bërë në datën 24 janar, njoftimin e dytë që ka shtuar pikën 10, që është me interes dhe është objekt i këtij shqyrtimi. Do depozitoj një vendim, vendimin nr.5, datë 28.01.2022, që ka të bëjë me dhënien e bursave. Në pikën e parë thuhet për 13 nxënës dhe në pikën e dytë për 8 nxënës të tjerë, kështu që korrigjoj dhe gabimin tim, bëhet fjalë për 21 nxënës dhe një vendim të këshillit bashkiak nr.7, datë 28 janar 2022. Të gjitha këto vendime të datës 28 janar 2022 që kanë miratuar ndihmën ekonomike për 89 familje. Pra, bursa, grante për rindërtimin, ndihmë ekonomike, si dhe njoftimin e rendit të ditës dhe vendimin e marrë për përfitimin e ndihmës ekonomike të 116 familjeve në mbledhjen e datës 25 shkurt 2022. Faleminderit!

*Z. I. Celibashi:* Mirë, faleminderit zoti Logu! Do t'i administrojmë të gjitha ato akte të cilat ju listuat, të Këshillit të Bashkisë Durrës. I japim fjalën përfaqësuesit të Bashkisë Durrës në lidhje me pretendimet e paraqitura jo vetëm sot nga përfaqësuesi i Partisë Demokratike, por në tërësi për gjithë denoncimin. Faleminderit!

*Z. A. Isaku, përfaqësues i Bashkisë Durrës:* Faleminderit zoti Komisioner! Ne jemi njohur me denoncimin nëpërmjet Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me denoncimin e subjektit politik dhe kemi komunikuar me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve nëpërmjet shkresave zyrtare. Mund të citoj këtu shkresën e datës 09.02.2022, nëpërmjet së cilës ne i kemi kthyer përgjigje Komisionit Qendror të Zgjedhjeve duke i listuar një sërë vendimesh të Këshillit Bashkiak Durrës, vendime që kanë të bëjnë me rindërtimin. Pra, me sa u pretendua nga subjekti politik ankimues, ne jemi para faktit që institucioni i Bashkisë Durrës ka respektuar vetëm ligjin. Ne jemi njohur si administratë me datën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak,

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 15.03.2022*

që ishte data 28 janar, jemi njohur në datën 13 janar. Në datën 20 janar institucioni i Presidentit të Republikës së Shqipërisë dekretoi datën e zgjedhjeve dhe me dekretimin e datës së zgjedhjeve, ne ishim përpara një fakti që kishim dokumentacion të depozituar. Lidhur me kalimin e këtij vendimi që lidhet me 526 familjet është e vërtetë që këto familje kanë kohë që kanë aplikuar për pjesën e grantit, por procesi i rindërtimit, sidomos në Bashkinë e Durrësit është një proces, i cili nuk ka mbaruar ende. Është një proces që është në vazhdimësi dhe pasojat e fatkeqësisë janë të dukshme dhe në këtë aspekt nuk mundet që një vendim i tillë mos të kalonte në kohën kur ne sapo kishim marrë fondet nga këshilli i ministrave. Gjithsesi siç jua thashë, të gjitha vendimet që lidhen nga viti 2021 dhe deri më sot janë të listuara në shkresën, të cilën ne jua kemi dërguar zyrtarisht. Shkresa mban numrin 1247/1. Në vijim jemi njohur, pra Komisioni Qendror i Zgjedhjeve na ka sjellë, na ka kërkuar informacion lidhur me itinerarin sesi ka proceduar njoftimi për mbledhjen e këshillit bashkiak dhe dokumentacioni që është kaluar në këshillin bashkiak, dokumentacion të cilin dhe këtë ua kemi sjellë me shkresën tjetër 1247/3, të 22 shkurtit 2022, si dhe vendimet të miratuara në atë mbledhje, vendime të cilat janë të konsultueshme dhe në *ëbsite*-in e faqes së bashkisë dhe të Këshillit Bashkiak Durrës. Përsa i përket shkresës tjetër ne e kemi kaluar tek sektori i gjendjes civile pjesën që u takon pretendimeve që u tha nga subjekti ankimues lidhur me numrin e votuesve dhe kjo është perceptuar si numër votuesish për herë të parë dhe përgjigjja ka qenë e tillë, 13 votues për herë të parë nga këto 526 familje përfituese. Lidhur me pretendimet që janë ngritur përsa i përket shkeljes së vendimit të Komisionit Rregullator, vendimit nr.9 të 24.12.2020, ku ky vendim i Këshillit Bashkiak Durrës përfshihet tek vendimet ose veprimtaritë e ndaluara, desha të citoja pikën 1.2, ku thotë që: “Përjashtimisht në rastet e vendosjes së masave të jashtëzakonshme për shkak të gjendjes së fatkeqësisë natyrore, apo epidemisë, pandemisë, nuk zbatohen

*Zbardhi materialin audio*

*Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 15.03.2022*

përcaktimet e pikës 1.1, sepse procesi i rindërtimit nuk është proces, i cili mund të stopojë. Në momentin që ne na vijnë fondet nga qeveria ne duhet t'u japim përparësi njerëzve, të cilët kanë vuajtur dhe po vuajnë pasojat e këtij tërmeti. Unë desha vetëm, pavarësisht se është pak jashtë objektit mendoj të hetimit, por dhe sa u tha subjekti ankimues, subjekti politik, lidhur me ndihmën ekonomike. Në pikën 1.1 të nenit 3 të po këtij vendimi, pra vendimit nr. 9 të Komisionit Rregullator, citohet "Veprimtaritë e ndaluara janë veprimtari publike sipas përkufizimit të nenit 2 të këtij vendimi, për të cilat janë vënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion, apo janë transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor të miratuar. Ndihma ekonomike është ndihmë e cila u jepet njerëzve në nevojë dhe kjo ndihmë u jepet njerëzve çdo muaj nga Bashkia e Durrësit". Fondi është i miratuar në buxhetin e Bashkisë Durrës. Pra, nuk përfshihet tek veprimtaritë e ndaluara që pretendohen nga subjekti politik ankimues. Gjithsesi dhe prapësimet ne i kemi depozituar. Ky vendim, desha të shtoj dhe diçka tjetër, që vijon si pjesë e një vazhdueshmërie, pra është një proces që vazhdon, që do vazhdojë dhe në ditët në vijim. Pra, mbledhjet e këshillit bashkiak nuk do ndalojnë për pjesën që u takon këtyre llojeve të vendimeve të këshillit bashkiak. Ne kemi depozituar dhe prapësimet tona me shkrim.

**Z. I. Celibashi:** Po, faleminderit! Një pyetje nga ana ime. Lista e përfituesve nga fondet e rindërtimit si krijohet si listë? Është bazuar në aplikimet individuale, apo vetë Bashkia Durrës nëpërmjet verifikimeve që mund të ketë bërë në terren ka krijuar një listë, si krijohet kjo lista e përfituesve? Dhe ky nuk është i vetmi rast ku janë dhënë ndihma apo janë dhënë mbështetje financiare për këtë kategori përfituesish, apo jo?

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 15.03.2022*

**Z. A. Isaku, përfaqësues i Bashkisë Durrës:** Atëherë, pranë Bashkisë Durrës është zyra e posaçme e rindërtimit, e cila në bazë të aplikimeve që bëjnë qytetarët për dëmet e tërmetit, nxjerr një listë përfituesish. Në rastin konkret, por dhe në raste të tjera, kjo listë përfituesish, e cila është publikuar nuk ka përfituar fonde. Pra, nuk është se këta njerëz kanë marrë fonde nga buxheti i shtetit. Këta janë në fazë fillestare. Këtyre thjesht u ka dalë emri në listë që plotësojnë kriteret dhe pastaj do vazhdohet me kriteret e tjera ligjore, nënshkrimin e kontratës apo procedura të tjera ligjore.

**Z. I. Celibashi:** Domethënë lista ndërtohet bazuar në aplikime individuale dhe shpreh interesin nga gjithsekush që pretendon se kualifikohet për të përfituar nga fondet e rindërtimit, kështu? Dhe pastaj Bashkia Durrës bën verifikimet përkatëse dhe në terren, apo mbledh informacione të tjera për të vërtetuar nëse pretendimet e dikujt që kualifikohet për të përfituar fonde nga rindërtimi qëndrojnë ose jo? Dhe vendimmarrja juaj e këtij rasti, po edhe më herët është e tillë, konsiston pikërisht në përgatitjen e kësaj liste dhe në një moment të dytë ose të tretë ju përmbushni detyrimin qoftë nëpërmjet dhënies së fondeve apo strehimit? Në rastin konkret jemi në momentin kur ju e keni finalizuar këtë listë. Pra, keni përcaktuar listën e atyre familjeve dhe, ose personave, të cilët kualifikohen për të përfituar nga ndihma për shkak të pasojave të tërmetit. Besoj që ka grupe, familje, apo individë të cilët e kanë përfunduar këtë proces. Pra, janë kualifikuar, janë përfshirë në atë listë dhe kanë përfituar dhe fondet, kështu është? Mirë, faleminderit! Pyetje zoti Logu?

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Po, faleminderit zoti Komisioner! E kuptoj që ne do kemi qëndrime të ndryshme, por le t'u qëndrojmë të paktën besnikë fakteve. Po themi, po të lexojmë për shembull vendimin nr.11, datë 28 janar 2022, në pikën 1 të


*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 15.03.2022*

tij thotë: “Miratimin e dhënies së përfitimit sipas listës së 13, etj,etj sipas listës klasifikuar si më poshtë”, dhe thotë: “Për kategorinë e dëmit DS1, 126 aplikime me vlerë 12 milion e 600 mijë lekë, të reja po flasim. Për kategorinë e dëmit DS2, 171 aplikime, me vlerë 42 milionë e 750 mijë lekë. Për kategorinë e dëmit DS3, 229 aplikime me vlerë 114 milionë e 500 mijë lekë. Në total 169 milionë e 850 mijë lekë”. Afërsisht 1.4 milionë euro, flasim. Është përcaktuar në vendim shuma. Pra, nuk jemi thjesht në kuadrin teorik që thonë këta do përfitojnë, thjesht janë kualifikuar se dihet se kur do përfitojnë, se sa, etj, etj, kjo mbetet për t’u parë. Dhe sjell në vëmendjen tuaj, zoti Komisioner, sepse i kemi parë me shumë vëmendje aktet, në mënyrë që pastaj mos thjesht të aludojmë, mos ta kthejmë këtë në një debat retorikash politike. Në relacioni e këtij projektvendimi në faqen e dytë thuhet: “Zyra e posaçme etj...lidhur me aplikimet e bëra në datën 1 shkurt 2020 deri në datën 6 mars 2020”, nga data 11 korrik 2020 deri në datën 18 korrik 2020. Kjo është data që janë bërë aplikimet në sistemin elektronik “Shtëpia ime”. Ka një sistem Bashkia Durrës, në të cilin qytetarët aplikojnë. Megjithëse ka dhe raste dhe zotëria që është prezent mund ta konfirmojë kur vetë bashkia, zyra e posaçme përfshin subjekte që mendojnë që i plotësojnë kriteret dhe do të doja të sillja në vëmendje zoti Komisioner, që mos ta lëmë në harresë, që në atë datë është marrë dhe një vendim tjetër, vendimi nr. 12 që thotë “Miratimin e listës së 9, të 6 subjekteve përfituese të cilat do përfitojnë masën e grantit të rindërtimit të banesave individuale sipas tabelës bashkëlidhur”, dhe në fakt ka 6 familje, të cilat kanë përfituar katër prej tyre, secila ka përfituar nga 2 milionë e 617 mijë e 558 lekë të reja dhe dy të tjera kanë përfituar 3 milionë e 428 mijë e 958. Në total 17 milionë e 328 mijë e 148 lekë, ose po ta konvertojmë në euro rreth 142 mijë euro për 6 familje të tjera. Pra, jemi në kushtet kur në këto dy vendimmarrje janë shpërndarë 1.5 milionë euro për 532 familje të Bashkisë së Durrësit. Flasim për shifra dhe vlera konkrete. Kështu që dhe për

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 15.03.2022*

aplikime, të cilat ishin bërë në rast të caktuar rreth dy vite më përpara, ne mund ta kuptojmë. Tani sa u përket interpretimeve ligjore. Kur flasim për nenin 3 të vendimit nr. 9/2020 duhet të kemi parasysh që thuhet “veprimtari të ndaluara për t’u promovuar”. Pra, ndalohen të promovohen ato veprimtari publike për të cilat janë vënë posaçërisht në dispozicion fonde publike dhe nuk po flasim për ndalimin e përgjithshëm që e ka në fakt neni 3, pika 3 e të njëjtit nen, që thotë: “katër muaj para datës së zgjedhjeve ndalohet nxjerrja e akteve ligjore dhe nënligjore”. Kështu që ne mos të bëjmë, po themi keqinterpretime të ligjit. Nga ana tjetër zoti Komisioner është e vërtetë që pika 1.2 thotë “përrjashtimisht në rastet e vendosjes së masave të jashtëzakonshme për shkak të gjendjes së fatkeqësisë natyrore, epidemisë apo pandemisë”. Por, a jemi ne sot në ndonjë gjendje të fatkeqësisë natyrore? A ishim ne më 28 janar në gjendje të fatkeqësisë natyrore? Në vlerësimin tonë nuk di të kemi qenë në një gjendje të tillë. Kështu që edhe kjo si arsyetim ligjor bie dhe ajo për të cilën nuk ka asnjë lloj shpjegimi unë dua ta pyes, dua të insistoj në fakt në këtë pyetje për drejtorin juridik të Bashkisë Durrës. Zoti drejtor, vendimi nr.13 i datës 25 shkurt 2012 për t’u akorduar ndihmën ekonomike 90 familjeve, vlerësoni se është në atë që neni 91, pika 4 ka synuar të ndalojë, pra, nxjerrjen e akteve nënligjore që nxjerrin përfitime për kategori të caktuara shoqërore në një periudhë që ishim në fushatë zgjedhore. Fushata zgjedhore ka filluar në datën 19 shkurt, se qartazi po themi për vendimet e datës 28 janar ndaj mendime të ndryshme kur ka filluar afati i ndalimit. Po për vendimin e datës 25 shkurt, si e vlerësoni? Jemi në kushtet e ndalimit?

*Z. A. Isaku, përfaqësues i Bashkisë Durrës: Atëherë pikë së pari desha të shpjegoj vetëm pjesën e terminologjisë së vendimit të këshillit bashkiak lidhur me DS1 që i përkon një shifre të caktuar, etj. Ajo është thjesht në kuptimin që janë kaq familje të cilat mund të përfitojnë DS1 dhe i përkojnë një shume të caktuar monetare. Pra,*

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 15.03.2022*

sepse ato janë të klasifikuara, nuk është se këto i kanë marrë këto fonde, ose janë transferuar fondet. Këtyre 526 familjeve nuk u kanë kaluar fondet.

*Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:* Zoti Isaku që ta keni dhe ju të qartë. Nuk është se ne themi që u janë kaluar, se momenti kur u janë kaluar, po themi ndjek një procedurë të caktuar, se të gjithë kemi një lloj eksperience në administratë, por ajo që themi ne është që këtyre qytetarëve u është njohur e drejta për të përfituar këtë shumë të caktuar në rezultat të disa procedurave që ato po i ndjekin hap pas hapi. Se ne e kuptojmë që buxheti i shtetit nuk është si portofoli i çdo qytetari që e nxjerr nga xhepi dhe ia jep dikujt në dorë, sigurisht që ndjek një procedurë të caktuar. Nuk kemi asnjë keqkuptim në këtë pikë.

*Z. A. Isaku, përfaqësues i Bashkisë Durrës:* Pra, pjesa e vendimit që lidhet me 526 familjet është fillim procedure dhe nuk është finalizuar. Ndërsa pjesa i përket vendimit të ndihmës ekonomike, unë e sqarova dhe pak më parë. Ndhima ekonomike është planifikuar në buxhet dhe ndihma ekonomike tre mijë lekë për ata qytetarë, bashkia nuk mundet mos ta japë ndihmën ekonomike. Nuk konsiderohet në aspektin tonë, në terminologji veprim pra, pjesë e veprimtarisë së ndaluar, pavarësisht se ishin zgjedhjet.

*Z. I. Celibashi:* Më fal, po thoni që është pjesë e veprimtarisë, të themi të përditshme të bashkisë, bazuar në fondin që bashkia ka përcaktuar për ndihmë ekonomike dhe kategoritë e personave që përfitojnë këtë ndihmë ekonomike. Kjo ndihmë ekonomike ndahet një herë në muaj?

*Z. A. Isaku, përfaqësues i Bashkisë Durrës:* Po!

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 15.03.2022*

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Kemi pyetje tjetër zoti Logu, para se të vazhdojmë?

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Kërkojmë që të na vihet në dispozicion informacioni që nuk e kemi, që i përket faktit që ne nuk kemi kërkuar informacion lidhur me zgjedhësit për herë të parë, por kemi kërkuar informacion sa janë, në këto familje sa zgjedhës ka, për herë të parë, për herë të dytë, për herë të dhjetë?

**Z. I. Celibashi:** Mirë, dakord! Atëherë ju e keni këtë informacion në lidhje me numrin e votuesve që përfshijnë këto familje? Sot nuk e kemi? Por mundet ta sillni? Patjetër! Atëherë do ta sillni këtë informacion dhe pastaj do të vlerësojmë sesa ky informacion është relevant në lidhje me çështjen që po shqyrtojmë, por gjithsesi do duhet ta sillni! Dhe nëse është e mundur një informacion shpjegues në lidhje me shpërndarjen e ndihmës ekonomike. Kush përfiton, pse, kur dhe si shpërndahet kjo ndihmë ekonomike? Këto dy kërkesa. Po zoti Logu, kemi ndonjë kërkesë shtesë?

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Jo, nuk kam kërkesë shtesë zoti Komisioner! Thjesht faktin që ne kemi kërkuar ta kuantifikojmë sa ka qenë përfitimi nuk është ngushtësisht e lidhur me këtë procedurë që ne po ndjekim sot. Pra, ne vlerësojmë që faktet që ka në dispozicion Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, faktet, provat që ka, dokumentacioni është mjaftueshëm për të konkluduar në atë që janë kërkimet tona, në qoftë se vendimet, katër vendimet e datës 28 janar 2022 dhe vendimi nr. 13 i datës 25 shkurt 2022 janë apo jo në kundërshtim apo në përputhje, në varësi nga ajo që do përcaktojë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me nenin 91, pika 4 dhe me nenin 3, pika 3 të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator.

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 15.03.2022*

**Z. I. Celibashi:** Domethënë nuk keni interes për numrin e tyre?

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Patjetër që ka interes përsa kohë e kemi kërkuar, por siç e kam shpjeguar në fakt edhe në atë proces kur është kërkuar, po themi, kjo si informacion, kjo i nderuar u shërben subjekteve zgjedhore, u shërben sigurisht edhe KQZ-së vetë për të kuptuar sesa ka qenë impakti real tek votuesit dhe tek procesi zgjedhor i kësaj vendimmarrjeje, i cili në vlerësimin tonë është i paligjshëm.

---

**Z. I. Celibashi:** Dakord! Atëherë kërkesa të tjera nuk kemi? Mirë, faleminderit! Seancën e mbyllim për sot dhe seanca tjetër do të njoftohet zyrtarisht, por besoj tri ditë janë të mjaftueshme për ju për ta sjellë këtë informacion. Mirë, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



**RENDI I DITËS**

Projektvendim “ Për shqyrtimin administrativ për shkelje të parashikuar në nenin 91, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ndaj Bashkisë Rrogozhinë”.

**PJESËMARRJA :**


- KQZ
  - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve Z. Ilirjan Celibashi
  - 2.Stafi KQZ: Y. Merkaj, M. Koja
- Parti Politike: PD (M. Logu)
- Bashkia Rrogozhinë: (E. Kacani)
- OJQ KRIK

*Z. I. Celibashi:* Mirë, atëherë kalojmë tek pika tjetër e rendit të ditës që ka të bëjë me denoncimin e Partisë Demokratike kundrejt Bashkisë Rrogozhinë. Para se të fillojmë përfaqësuesi i Partisë Demokratike është këtu. Nga Bashkia Rrogozhinë? Prezantohuni ju lutem!

*Znj. E. Kacani, përfaqësuese e Bashkisë Rrogozhinë:* Elona Kacani, punonjëse në drejtorinë Juridike të Burimeve Njerëzore në Bashkinë Rrogozhinë dhe Edlira Romaj me autorizim.

*Z. I. Celibashi:* Mirë, faleminderit! Atëherë fjala për ju!

Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 15.03.2022*

*Znj. M. Koja:* Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve në 14 shkurt është administruar një denoncim nga subjekti zgjedhor Partia Demokratike, me objekt: “Emërimi i përkohshëm në punë, në Bashkinë Rrogozhinë”, në shkelje të pikës 3, të nenit 91 të Kodit Zgjedhor. Menjëherë pas administrimit të denoncimit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka filluar procedurat e shqyrtimit administrativ, hetimit administrativ, duke iu drejtuar fillimisht Bashkisë Rrogozhinë, për dhënien e informacionit në lidhje me sa pretendohet në denoncim. Bashkia Rrogozhinë i është përgjigjur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe nëpërmjet shkresës së saj sqaron se kjo bashki përse pretendohet në denoncim, nuk ka kryer punësime në datën 25 janar 2022, por nisur nga njoftimi që kësaj bashkie i është bërë nga ana e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, në të cilën parashikoheshin temperatura të ulëta për ditët në vijim, i kërkohet Bashkisë Rrogozhinë marrja e masave për përballimin e situatave si pasojë e kushteve të vështira të motit, me qëllim rritjen e gatishmërisë dhe marrjen e masave paraprake. Në këto kushte Bashkia Rrogozhinë sqaron se në datat 20 dhe 21 janar 2022 ka kryer 27 punësime të përkohshme, marrëdhënia financiare e të cilave është ndërprerë që prej datës 5 shkurt 2022. Në shkresën e Bashkisë Rrogozhinë sqarohet se ndryshe nga sa pretendohet nuk janë punësime me afat tremujor, për qëllime të posaçme elektorale, por janë punësime sezonale të përkohshme, vetëm me qëllim përballimin e situatës së emergjencës së dimrit, dhe Bashkia Rrogozhinë nga data 25 e në vazhdim nuk ka kryer asnjë punësim tjetër. Bashkëlidhur pretendimeve të Bashkisë Rrogozhinë, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve janë administruar dhe provat përkatëse ku janë aktet e emërimit të 27 punonjësve dhe nga sa konstatohet, urdhrat e emërimit datojnë në datën 20 dhe 21 shkurt dhe në përmbajtje të urdhrit data e përfundimit të marrëdhënieve financiare është data 5 shkurt 2022. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 15.03.2022*

**Z. I. Celibashi:** Po, faleminderit! Fjala për përfaqësuesin e Partisë Demokratike!

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Faleminderit zoti Komisioner! Në fakt pranë Partisë Demokratike nga ana e strukturave tona lokale na është vënë në dispozicion një listë emërore me 44 persona, të cilën unë do ta depozitoj pranë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në cilësinë e provës, në të cilën rezulton që të paktën nga këta 44 persona, të gjithë punonjës sezonalë, disa me detyra edhe sanitare, 29 prej tyre janë punësuar pas datës 20 janar 2022 dhe mbajnë data të ndryshme. Dy prej tyre datën 20 janar, disa të tjerë në datën 24, 21, 25 etj, etj dhe përgjithësisht janë individë të punësuar deri në datën 25 prill 2022. Pra, për një periudhë 3 mujore. Fshatrat dhe zonat ku ata do ushtronin detyrat e tyre janë Gosë, Kryevidh, Rrogozhinë, Lekaj, Gosë sërish, etj, etj, dhe ky është informacioni që na është vënë në dispozicion. Sigurisht që mekanizmat që kanë partitë politike në dispozicion për të verifikuar saktësinë e çdo informacioni që mbërrin pranë tyre janë të caktuara edhe kjo është arsyeja pse ne iu drejtuan Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve duke kërkuar kryerjen e një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm administrativ, për të zbuluar në qoftë se ishte rasti që ishim përpara shkeljeve të parashikuara nga neni 91, pika 3 që ndalon marrjen në punë, sidomos për efekt për qëllime zgjedhore me përjashtim të atyre rasteve kur ka qëllime të përligjura. Në vijim të këtij denoncimi të paraqitur nga ana jonë është kërkuar informacion, i cili ne na është përcjellë në datën 19 shkurt 2022 dhe me të cilin pasi jemi njohur kemi pasur këto konstatime. E para pranohet, Bashkia Rrogozhinë pranon që ka kryer punësime sezonale, punësime të përkohshme, punësime të cilat bashkia thotë i ka kryer në datën 20 dhe 21 janar. Arsyeja e këtyre punësimeve, thotë kryetari i Bashkisë Rrogozhinë, kandidat i Partisë Socialiste në zgjedhjet e 6 marsit, ishin sepse u informua nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile lidhur me faktin që do kishte kushte të vështira të


*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 15.03.2022*

motit që duhet të rrisnim gatishmërinë. Dhe në fakt ne e lexuam me vëmendje e-mail-in që i ka dërguar Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile ndër të tjera dhe Bashkisë Rrogozhinë, është një njoftim që u është drejtuar të 61 bashkive, për marrjen e masave, sepse mendohej që pas datës 25 janar do kishte një përkeqësim të kushteve klimaterike. Por, kini parasysh zoti Komisioner dy fakte të rëndësishme. E para veçanërisht theksohen zonat malore, se Bashkia Rrogozhinë, po të kesh parasysh dhe pozicionin e saj gjeografik, nuk është ndonjë bashki që rrezikonte të përballej me mot që do bllokonte rrugët, se ka zona të thella malore, etj, etj, kjo e para. E dyta, ajo që në fakt u është kërkuar bashkive është raportimi, informimi i banorëve, bashkëpunimi me kontraktorët e mirëmbajtjes së rrugëve, rritja e gatishmërisë së ARRSH-së, OSHEE-së OST-së, Ujësjiellës Kanalizimeve, të parashikohen nevojat e mundshme për bazë ushqimore, në atë rast kur do bllokoheshin banorët, dhe të rritet gatishmëria e të gjitha forcave operacionale. Janë masa që janë kërkuar nga kjo agjenci. E-mail-i në fakt ka arritur në datën 21 janar dhe siç ju lexova pak më herët thuhej dhe që janë bërë dhe punësime në datën 20 janar. Në fakt nga shkresat që na kanë ardhur shikohet se disa punësime janë bërë në datën 20 janar. Pra, nuk qëndron, të paktën për këta banorë të punësuar në datën 20 janar, pretendimi se në vijim të atij njoftimi që na u bë nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile ne morëm masa dhe punësua 27 persona që të rrinin në gatishmëri, sepse veçse në qoftë se Bashkia Rrogozhinë ka aftësinë që ta parashikonte vetë se do i vinte një e-mail nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes së Mjedisit do të merrte masa paraprakisht, se përndryshe nuk ka sesi të qëndrojë ky si pretendim, në këtë rast. Nga ana tjetër, për asnjë moment, në fakt nuk thuhet dhe nuk është thënë askund se duhen angazhuar punonjës shtesë, duhen angazhuar forca shtesë. Kërkohej që ato punonjës dhe ato struktura që janë aktuale të qëndrojnë në gatishmëri duke angazhuar dhe disa struktura që përgjithësisht angazhohen në kushte

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 15.03.2022*

të vështira, për pesë ditët e motit në vijim. Megjithatë në mënyrë të menjëhershme duket që Bashkia Rrogozhinë është angazhuar dhe ka punësuar vetëm një ditë në rastin e parë, vetëm një ditë pasi ishte dekretuar procesi zgjedhor, rreth 23 punonjës, pjesa tjetër janë punonjës të punësuar, dy prej tyre në datën 21 dhe dy të tjerë në datën 20, pra përkatësisht punonjësit, shtetasi Emiljan Deda dhe shtetasi Agustin Kajana, pa e shpjeguar në fakt dhe vazhdon të mbetet pak e paqartë se cilat do ishin detyrat e këtyre punonjësve. Nuk na është vënë në dispozicion dhe sigurisht që ne kërkojmë të na vihet në dispozicion, sepse ka disa paqartësi lidhur me faktin si ka mundësi që Bashkia Rrogozhinë ka punësuar njerëz për manaxhimin e kushteve klimaterike, me të cilat janë njoftuar në datën 21, por i ka punësuar që në datën 20, kjo mbetet e paqartë për ne. Ajo që mbetet e paqartë është po themi dhe mbase do ta ngremë dhe në nivel pyetjeje, a ka pasur praktikë të mëparshme Bashkia Rrogozhinë që gjatë periudhës së dimrit punëson forca shtesë dhe në qoftë se po, cilat janë detyrat që kryejnë këta punonjës? Pyetja e tretë që është e rëndësishme është, si është e mundur që brenda pak orëve, se e-mail-i ka ardhur në datën 21 në orën 10:00, dhe brenda pak orëve janë punësuar 25 persona, cilat ishin kriteret për punësimin e këtyre personave? Ku u gjetën këta persona? Se duket e çuditshme që brenda pak orëve të ketë siguruar po themi gjithë këto kapacitete. Në vlerësimin tonë, zoti Komisioner është e qartë pse janë kryer këto punësime. Nuk kanë të bëjnë këto fare, edhe po të marrësh Bashkinë Rrogozhinë, territorin, pozicionin gjeografik, nuk kanë të bëjnë këto fare me kushtet klimaterike të kësaj bashkie. Aq më tepër, që ne në fakt e kemi, kërkojmë dhe që të marrim informacion sepse dy shtetas na rezultojnë me të njëjtin mbiemër, me mbiemrin e kryetarit të bashkisë dhe kam përshtypjen që duhet të jenë familjarë. Pra, qartazi e kemi denoncuar dhe në zgjedhjet e 25 prillit, por është një proces që tashmë i është nënshtruar procedurave të tjera. E kemi denoncuar, vazhdojmë ta denoncojmë në këtë proces që ka një praktikë të përsëritur të kësaj

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 15.03.2022*

bashkie, megjithëse një bashki e vogël për të shtuar numrin e punonjësve të saj në periudha zgjedhore. Megjithatë, për efekt të një vlerësimi të plotë dhe të gjithanshëm ne kërkojmë që për secilin nga këta 44 persona, të cilët janë në këtë listë të na vihen në dispozicion këto informacione: A rezultojnë të punësuar aktualisht në Bashkinë Rrogozhinë? Nëse po, cila është data e fillimit të marrëdhënies së tyre e punës dhe cila është data e përfundimit? Në qoftë se është rasti që kanë përfunduar, se ndoshta vazhdojnë të jenë të punësuar, të na vihen në dispozicion kontratat e punës përkatëse.

Të na vihen në dispozicion vërtetimet nga drejtoria financiare, që kanë të bëjnë me pagesat e kryera për këta persona. Në qoftë se këta persona kanë qenë më përpara të punësuar, pra kanë qenë në një kohë të mëparshme, kanë filluar dhe kanë përfunduar detyrat e tyre dhe kontratat përkatëse, dhe do donim të dinim se cila është marrëdhënia që kryetari i bashkisë zoti Edison Memolla ka me shtetasit Besnik Memolla dhe Gëzim Memolla, të cilët rezultojnë të punësuar në periudhën sezonale. Dhe një informacion tjetër që pata mundësi ta parashtroj dhe më përpara, cilat janë detyrat që kanë mbuluar këta 27 persona që pretendohen të punësuar në këtë periudhë, të cilët në vlerësimin tonë rezultojnë më shumë se aq, dhe përveç detyrave që ata kanë kryer, cilat janë kriteret apo si është realizuar rekrutimi i këtyre punonjësve? Pra, ka pasur një fazë konkursi nga data 21 janar në orën 10:00, brenda datës 21 është zhvilluar konkurs, janë hapur aplikime, janë mbyllur aplikime, është mbledhur komisioni, ka vlerësuar aplikimet, i ka marrë në intervistë, i ka pyetur, pasi i ka pyetur është bindur që këta shtetas janë më të përshtatshmit dhe më pas ka lidhur kontratën e punës, apo thjesht është ulur dikush dhe ka marrë po themi, ka plotësuar një listë me emra personash, të cilët mund të rezultojnë ndoshta dhe anëtarë ose përkrahës të ndonjë partie politike. Kur vjen puna tek Rrogozhina, zoti Komisioner, unë mendoj që një nga mënyrat sesi e parashikon në fakt neni 9, i vendimit nr. 9, datë 9 mars 2021 të Komisionit Rregullator, që një nga mënyrat për marrjen e provës

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 15.03.2022*

janë edhe aktet e tjera që dokumentohen nëpërmjet mjeteve fotografike të regjistrimit ose mjeteve të tjera teknike, dhe unë kërkoj që nga ana juaj të merret dhe kjo provë që ne do paraqesim në këtë moment, në cilësinë e provës që i shërben këtij procesi sa i përket procesit zgjedhor në Bashkinë Rrogozhinë.

-Alo!

-Alo!

-Përshëndetje!

-Përshëndetje!

-Si jeni?

-Mirë, po ti?

-Mirë, më fal se nuk më del numri!

-E di që nuk të del numri, se nuk e ke numrin tim ti, prandaj s'të del!

-Po, më thuaj!

-Unë jam...!

-Çfarë halli kishe?

-A të thashë unë atë ditë për dritat se më kanë ardhur për të prerë dritat?

-Eee...

-Po, pra!

-Erdhën t'i prenë? Po i thashë unë atij çunit!

-Jo ai çuni është aty përjashta... Unë të thashë atë ditë që s'kam mundësi të paguaj...

-Po, a është aty ai çuni? Foli të dalë njëherë në telefon!

-S'e di në fakt për sot... na çoi pak telefonin atij t'i flasë xhaxhi kryetarit!

-O xhaxh, na foli pak xhaxhi kryetarit!

-Kush kryetar?

-I Rrogozhinës, po kush?

-Alo!

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 15.03.2022*

-Alo!

-Urdhëro!

-Çfarë bën, si je? Do ia ndërprisni, po lëre të kalojë ky muaj!

-Ja të kalojë ky muaj, po muaji tjetër?

-Muajin tjetër shohim e bëjmë. Shih t'i marrim ato që kemi marrë se jemi në zgjedhje, apo jo?

-E di, e di, po çfarë të bëj unë!

-Po hajde një herë të paguajë një muaj se aq lekë ka!

- Këtu ka pesë muaj, ti thua një muaj!

-Po, po të paguaj një unë, tjerat shiko t'ia shtysh po qe se keni probleme me KESH

...Na kanë hequr nga dy javë punë.

-Pse, pse s'keni prerë?

-Po!

-Hajde se diskutojmë njëçikë me Edin! Lëre sot ashtu, flasim nesër, të flas njëçikë me Edin unë..., apo do të raportosh ti?


-Jo, jo, për sonte jam kam lënë vetë unë për dy-tre ditë, por...

-Mirë të flas me Edin unë, të flas me ata të mëdhenjtë që mos t'ju bezdisin. Mirë?

-Mirë!

*Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:* Pra, zoti Komisioner kemi të bëjmë me një bisedë të transmetuar në media, në datën 4 mars 2022, ndërmjet kryetarit të bashkisë në detyrë dhe kandidati i Partisë Socialiste me një qytetar të Rrogozhinës dhe më pas më një elektrikist të zonës, të cilit i premtohet se kryetari i bashkisë do paguajë një muaj drita dhe mos ia prit, i thotë, se do flas unë me ata lart, se kemi ato që duhet t'u marrim ato, se jemi në zgjedhje. Rast më flagrant që provon sesa të rregullta, sa të ndershme, sa të pastra ishin zgjedhjet e 6 marsit në Bashkinë Rrogozhinë, nuk besoj

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 15.03.2022*

se mund të ketë. Ndoshta këtu është rasti për të kujtuar sigurisht nenin 78, pika 7 të Kodit Zgjedhor, i cili parashikon se “subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve u ndalohet dhe mbajnë përgjegjësi penale në rast se ofrojnë ose japin të holla, të mira materiale, premtojnë për vende punë, ose favorizime të tjera për zgjedhësin, ose persona të tjerë të lidhur me të, me qëllim për të votuar në një mënyrë të caktuar”, thotë Kodi Zgjedhor. Kështu që në përfundim, zoti Komisioner, kërkojmë që nga ana juaj të merren masat e caktuara sipas asaj që mbulon Kodi Zgjedhor dhe aktet nënligjore të KQZ-së për atë bisedë që ne sapo dëgjuam, kjo e para, dhe e dyta sa u përket punësimeve, të cilat janë denoncuar nga ana jonë, të na vihen në dispozicion aktet që kërkuam në mënyrë që më pas të kemi mundësi të bëjmë konkluzionet tona mbi këto akte. Ndoshta për një pjesë të atyre gjërave që kërkuam, përfaqësuesit e Bashkisë Rrogozhinë mund të na japin dhe përgjigjen meqenëse ndodhet këtu edhe vetë personi përgjegjës i burimeve njerëzore pranë kësaj bashkie.

*Z. I. Celibashi:* Po, faleminderit zoti Logu! Përfaqësues të Bashkisë Rrogozhinë në lidhje me denoncimin në tërësi, por veçanërisht mesa u prezantua tani nga përfaqësuesi i Partisë Demokratike!

*Znj. E. Kacani, përfaqësuese e Bashkisë Rrogozhinë:* Faleminderit zoti Komisioner! Atëherë sikundër kemi paraqitur edhe prapësimet me shkrim që janë vënë në dijeni dua të theksoj se punësimet e përkohshme janë bërë konkretisht në datat 20 dhe 21, janë kryer 27 punësimet, konkretisht dy janë bërë më datë 20 dhe 25 të tjerat janë bërë më datë 21. Pas këtyre datave nuk ka patur asnjë lloj punësimi tjetër nga Bashkia Rrogozhinë. Duhet thënë që situata e emergjencës është një situatë që është bërë edhe mediatike, përkon pikërisht me momentet me periudhën që edhe janë mbyllur shkollat në këtë periudhë. Gjithashtu, ndryshe nga çfarë u tha, Bashkia

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 15.03.2022*

Rrogozhinë edhe vjet ka patur precedentë të kësaj situatë, madje vjet ne kemi qenë në situatë akoma më të vështirë emergjence, sepse kemi patur dhe përmytje dhe është një situatë që është përsëritur në bashkinë tonë. Duhet thënë që këto punësime sezonale, që janë kryer në datat 20 dhe 21, janë punësime të cilat janë bërë vetëm për qëllime emergjence. Duke qenë se marrëdhënia financiare ka përfunduar që më datë 5 shkurt 2022, nuk ka se si të ketë ndonjë ndikim elektoral, pasi zgjedhjet kanë qenë më datë 6 mars, ndërkohë që marrëdhënia financiare është ndërprerë që më datën 5 shkurt 2022, dhe kjo tregohet qartë dhe në aktet që ne kemi vënë në dispozicion dhe i kemi dërguar. Ndërkohë në lidhje me pyetjen se çfarë detyrash do të kishin këta persona, tek kthimi i përgjigjes që u jemi drejtuar është edhe një kërkesë për marrjen e masave për përballimin e situatës e bërë nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, ku përcaktohet se për çfarë do të shërbejnë këta punëtorë të përkohshëm, për të raportuar në kohë reale çdo problematikë, për mirëmbajtjen e rrugës, marrjen e masave, për normalizimin e situatave që mund të krijohen dhe të jenë në çdo kohë në gatishmëri në rastet e nevojave për bazën materiale dhe ushqimore. Duhet të theksoj edhe faktin që punësimet nuk quhen shtim në strukturë ose në organikë, pasi janë brenda numrit total të miratuar në strukturën që ka në fuqi aktualisht Bashkia Rrogozhinë. Kështu që këto emërimet janë plotësisht të përligjura në përputhje me nenin 3, të pikës 1.3, germa “d”, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, në të cilin thuhet që marrja në punë lejohet në rastet e emergjencave për shkak të ngjarjeve të parashikuara që diktojnë marrjen në punë. Faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Ndoshta për ta sqaruar akoma më mirë. Ju thoni që emërimet janë bërë brenda strukturës së miratuar. Në ç’kuptim? Se nëse këta janë punonjës me kohë të pjesshme, ju keni një numër paraprak punonjësish me kohë të

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 15.03.2022*

pjeshme, të cilët mund t'i merrni brenda një periudhe të caktuar, njëvjeçare, a nuk e di?

*Znj. E. Kacani, përfaqësuese e Bashkisë Rrogozhinë:* Po! Në strukturën që është aktualisht në fuqi parashikohet një numër total i punonjësve sezonalë që do të funksionojë në rast pas rasti, përgjatë gjithë vitit, dhe ai numër është 50, totali, dhe ky numër nuk është kaluar nga ana jonë.


*Z. I. Celibashi:* Kur është marrë ky vendim? Është vendim i Këshillit Bashkiak?

*Znj. E. Kacani, përfaqësuese e Bashkisë Rrogozhinë:* Atëherë, miratimi për strukturën është vendimi nr. 23, datë 21.01.2021, për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Rrogozhinë. Është struktura e vjetshme, pasi nuk është miratuar ende struktura për vitin 2022 duke qenë se kemi qenë në zgjedhje.

*Z. I. Celibashi:* Nga momenti që është miratuar ky vendim i Këshillit Bashkiak, sa herë, pra, që prej janarit 2021, nëse nuk gaboju ishte ai vendimi, dhe deri, të themi, në janar të vitit 2022, sa herë dhe sa në numër ju keni rekrutuar punonjës të përkohshëm?

*Znj. E. Kacani, përfaqësuese e Bashkisë Rrogozhinë:* Gjithmonë numri ka qenë në varësi të nevojave duke mos e kaluar numrin total prej 50. Kemi patur gjatë sezonit të plazhit punonjës të sezonalë, gjatë sezonit të shkollave kanë qenë sanitaret ekstra që punojnë nëpër shkollat, që përfshihen po tek numri i punonjësve sezonalë.

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 15.03.2022*

*Z. I. Celibashi:* Po! Nuk e kemi të saktë informacionin, pra sa herë dhe në këto herë sa ka qenë numri i punonjësve të rekrutuar?

*Znj. E. Kacani, përfaqësuese e Bashkisë Rrogozhinë:* Jo, tamam, tamam, nuk e kam për momentin, por që gjithmonë ka qenë në përputhje me numrin total të miratuar. Asnjëherë nuk e ka tejkaluar.

*Z. I. Celibashi:* Dhe për t'u kthyer tek çështja konkrete, 44 personat kur kanë filluar marrëdhënie kontraktuale dhe kur e kanë ndërprerë marrëdhënien kontraktuale me bashkinë?

*Znj. E. Kacani, përfaqësuese e Bashkisë Rrogozhinë:* Për 44 personat, kam përshtypjen që bëhet fjalë edhe për të tjerë, punonjësit që janë emëruar përpara datës 20, që mund të përfshihen sanitaret e shkollave që kanë filluar marrëdhëniet në fillim të janarit me fillimin e shkollës, ndërsa emërimet pas dekretit të Presidentit kanë qenë vetëm 27 emërime që kanë qenë deri më datë 5 shkurt. Pra, emërimet që janë bërë pas dekretit kanë qenë të përkohshme vetëm për përballimin e emergjencës, ndërsa personat e tjerë që mund të jenë futur përpara janë kryesisht sanitarë nëpër shkolla që vazhdon marrëdhënia edhe më vonë.

*Z. I. Celibashi:* Atëherë, pas datës 20 janar sa është numri i punonjësve me kohë të pjesshme që ju keni punësuar në bashki, domethënë pas datës 20 janar?

*Znj. E. Kacani, përfaqësuese e Bashkisë Rrogozhinë:* 27. Janë 27 punonjës, marrëdhënia e të cilëve është ndërprerë që më datë 5 shkurt 2022.

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 15.03.2022*

**Z. I. Celibashi:** Pra, i keni emëruar të themi datat 21, 22 apo 23 dhe të gjithëve këtyre u ka përfunduar marrëdhënia e punës në 5 shkurt.

**Znj. E. Kacani, përfaqësuese e Bashkisë Rrogozhinë:** Që më datë 5 shkurt, dhe këto janë emëruar posaçërisht për pjesën e emergjencës së dimrit.

**Z. I. Celibashi:** Keni të tjerë të punësuar përkohësisht pas datës 5 shkurt?

**Znj. E. Kacani, përfaqësuese e Bashkisë Rrogozhinë:** Pas datës 5 shkurt nuk ka asnjë të punësuar.


**Z. I. Celibashi:** Me kohë të pjesshme?

**Znj. E. Kacani, përfaqësuese e Bashkisë Rrogozhinë:** Me kohë të pjesshme, me kohë të plotë nuk është bërë asnjë lloj punësimi.

**Z. I. Celibashi:** Pra, nga data 20 janar deri në datën 5 shkurt ka qenë vetëm ai numri që thatë ju i punonjësve me kohë të pjesshme dhe pas datës 5 shkurt nuk keni patur asnjë lloj punësimi? Po, faleminderit! Keni ndonjë pyetje zoti Logu?

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Po, faleminderit zoti Komisioner! Pyetja ime ishte kjo. Rezulton që ka dy punonjës që janë punësuar në datën 20 janar, që pretendohet që janë punësuar po për shkak të kushteve klimaterike. E-mail-i i Agjencisë Kombëtare për Mbrojtjen Civile ju ka ardhur në datën 21, si qëndron kjo çështje?

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 15.03.2022*

*Znj. E. Kacani, përfaqësuese e Bashkisë Rrogozhinë:* Sikundër e përmenda dhe pak më përpara situata e emergjencës ka qenë një situatë, si të thuash, ne jemi përgatitur edhe paraprakisht ka qenë dhe nëpër media që priten kushte të vështira moti pavarësisht se e-mail-i i Agjencisë Kombëtare ka ardhur më datë 21, paraprakisht është menduar për katër punonjës, pastaj është menduar për shtimin e tyre duke qenë se nga komunikimet edhe jozyrtare, komunikimet telefonike dhe me prefekturën edhe me institucionet e tjera është menduar, stafi i bashkisë ka menduar rritjen gatishmërisë duke qenë se flitej dhe për mbylljen e shkollave. Kështu që u pa e nevojshme që të shtohet ky numër. Për më tepër në 21 erdhi edhe e-mail-i që e konfirmoi si të thuash situatën e emergjencës. Duhet thënë që periodha e emergjencës nuk ka qenë më datë 21, periodha e emergjencës ka qenë më përpara datës 21. Flitej që më datë 18, 17, kështu që nuk është një gjë që u vendos në atë moment.

*Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:* Ka një e-mail të datës 21 janar të Agjencisë Kombëtare për Mbrojtjen Civile, ekspertizën e të cilës besoj ne nuk e vëmë në dyshim, që thotë që temperaturat priten të ulen në datën 25 janar. Pra, ekspertiza e këtij institucioni besoj që nuk jemi këtu për ta diskutuar, a e dinin ata apo e dinte më mirë Bashkia Rrogozhinë? Ajo që ju pranuat është se e-mail-i i datës 21 ka qenë arsye shtesë, por nuk ka qenë arsyeja kryesore pse ju keni kryer punime sezonale, është kjo?

*Znj. E. Kacani, përfaqësuese e Bashkisë Rrogozhinë:* Jo, nuk thashë që nuk ka qenë arsyeja kryesore.

*Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:* Në rregull, ma shpjegoni!

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 15.03.2022*

*Znj. E. Kacani, përfaqësuese e Bashkisë Rrogozhinë:* Duhet thënë që këto punësime janë bërë posaçërisht për shkak të kësaj situatë, e cila na ishte komunikuar edhe më përpara, edhe në media është komunikuar më përpara, duke marrë parasysh dhe precedentët e mëparshëm të Bashkisë Rrogozhinë në periudhë janari, janë bërë këto emërime.

*Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:* Shiko, shteti funksionon me shkresa. Ne kemi një shkresë, një e-mail të datës 21 janar, të cilën na e keni sjellë. Ka punësime që janë kryer në datën 20 janar. Pra, kjo tregon për këdo, se komunikime verbale, telefonike, etj, etj, kjo pastaj ne nuk e investigojmë dot se nuk kemi sesi ta gjejmë. Pra, kjo në fakt provon faktin që Bashkia Rrogozhinë ka kryer punësime sezonale pavarësisht, e me gjithë, ndoshta po aq më tepër e-mail-it. Pyetja ime e dytë. E-mail-i ka ardhur në datën 21 janar, rreth orës 10:00. Thuhet në e-mail, si është kryer procesi i rekrutimit të punonjësve të rinj, dhe pyetjet janë konkrete, a ka pasur një shpallje publike për rekrutim të këtyre punonjësve? Nëse po, do duhet të na viheshin në dispozicion aktet. Cilat kanë qenë kriteret që të punësohej Gëzim Memolla dhe jo një qytetar tjetër i Bashkisë Rrogozhinë? Po e marr kot se mund të jetë secili prej tyre, pra cilat kanë qenë kriteret, cila është procedura që është ndjekur, ka pasur një verifikim të kritereve, ka pasur një vlerësim të këtyre kritereve, dhe kur është bërë shpallja e fituesve? Keni parasysh që e-mail-i vjen në orën 21, ora 10, shpallen shkresat për emërimin e tyre, janë bërë po në datën 21. Kam përshtypjen që nuk ka qëndruar administrata jashtë orarit zyrtar, kështu që brenda orës 16:00, pra në 6 orë janë kryer të gjitha këto procedura dhe janë emëruar të paktën 25 punonjës. Kështu që jemi shumë të interesuar për të ditur si është bërë procesi i rekrutimit të tyre.

*Zbardhi materialin audio*

*Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 15.03.2022*

*Znj. E. Kacani, përfaqësuese e Bashkisë Rrogozhinë:* Atëherë, pikë së pari nuk bëhet fjalë për emërim sipas procedurës së shërbimit civil. Këto janë pozicione punëtorë krahu, që do të thotë nuk është se kërkojnë kritere të rëndësishme, plus janë emërim të cilat janë bërë në kuadër emergjence. Vetëm për një periudhë 5 shkurt 2022, që do të thotë nuk kishim nevojë as për arsimim në drejtësi, apo një lloj arsimit tjetër, janë punëtorë krahu. Duhet thënë që në Bashkinë Rrogozhinë pjesa më e madhe e kërkesave për punë vjen nga punonjës të cilët kërkojnë punë krahu, që do të thotë ne kemi një listë me kërkesa qytetarësh që janë të interesuar të punojnë si punëtor krahu pranë institucionit tonë, janë marrë, janë verifikuar për shkak të emergjencës dhe është bërë emërimi. Pra, nuk kemi të bëjmë me një procedurë të mirëfilltë konkurimi pasi nuk janë pozicione të përleshme, për më tepër janë vetëm emërim që janë bërë në situatë emergjence. Kështu që nuk ka qenë e nevojshme për të bërë procedura rekrutime.


*Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:* Që ta bëjmë të thjeshtë fare pyetjen. Ku i gjetët këta 27 qytetarë, si i gjetët? Se mund të kishit gjetur këta 27, mund të gjenit 27 të tjerë, mund të gjenit nja 500 të tjerë që kërkojnë punë në Bashkinë Rrogozhinë. Pse këta 27 dhe jo 27 të tjerë? Ju lutem shumë, kini respekt për inteligjencën e secilit prej nesh këtu.

*Z. I. Celibashi:* Zoti Logu t'i lëmë komentet ju lutem!

*Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:* Ne e dimë shumë mirë në administratë publike se si punësohen njerëzit. Ne duam të dimë procedurën, të provuar me shkresa, sepse po vihet në dyshim a e kuptojmë ne që janë punëtor krahu dhe çfarë kualifikimesh kërkon punëtori i krahut. Unë e di çfarë kualifikimesh kërkon punëtori i krahut, unë

*Zbardhi materialin audio*

*Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 15.03.2022*

dua të di procesin e rekrutimit. Jam shumë i interesuar për të kuptuar si rekrutohet një punonjës sezonal, me kohë të pjesshme, me kohë të plotë, me kontratë, pa kontratë në Bashkinë Rrogozhinë. Më intereson kjo zoti Celibashi, jo vetëm për rregullsinë e procesit zgjedhor, por dhe për shkak se besoj që përdoren para publike për t'i paguar këta qytetarë. Kjo është ajo që unë përpiqem të kuptoj. Pyetja është e qartë, si janë gjetur këta 27. Pra, si janë përzgjedhur këta 27 dhe nuk janë përzgjedhur këta 27 të tjerë, dhe në atë listën, ju thatë që ka një listë të njerëzve që kërkojnë punë, kanë qenë vetëm këta 27 që kërkojnë punë, apo ka më shumë sesa thjesht 27, por ju përzgjedhët këta 27, se mund të ngrihet nesër dikush dhe të thotë diskriminim.

**Z. I. Celibashi:** Më fal para se ti përgjigjeni! Ju lutem adresoni pyetjet dhe do keni gjithë kohën që ju nevojitet për të komentuar përgjigjet e palës tjetër. Por, momentin që i drejtoni pyetje nuk mendoj që vlen që të komentoni përgjigjet hipotetike të palës tjetër. Keni gjithë të drejtën të bëni sa pyetje të doni, kur të doni dhe të bëni gjithë komentet në lidhje me përgjigjen që jep pala tjetër. Po, fjala për ju!

**Znj. E. Kacani, përfaqësuese e Bashkisë Rrogozhinë:** Faleminderit! Personat që janë punësuar deri më datë 5 shkurt kanë qenë persona të cilët kanë bërë kërkesë për punë, kanë paraqitur më përpara kërkesë për punë pranë Bashkisë Rrogozhinë.

**Z. I. Celibashi:** Pyetja ishte, në listën e personave që kishin bërë kërkesë për punësim ishin vetëm këta, apo ishte një listë edhe me persona të tjerë, e cila në mënyrë të vazhdueshme, apo nuk e di sesi shtohet apo pakësohet? Pra, këta persona që ju i punësua në datën 20, 21, lista e këtyre personave si u krijua? Ka qenë e krijuar më herët aty në bashki, ishte pjesë e një liste prej më shumë se 27 personash apo si? Kjo ishte pyetja pak a shumë!

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 15.03.2022*

*Znj. E. Kacani, përfaqësuese e Bashkisë Rrogozhinë:* Jo, nuk ka qenë pjesë e një liste më shumë sesa 27 persona, por thjesht kanë qenë persona në një dosje të caktuar që kanë paraqitur dëshirën për t'u punësuar. Janë kontaktuar dhe kanë qenë të gatshëm. Mund të jenë kontaktuar edhe më shumë sesa 27, këtë nuk mund t'ua them me siguri, por këta persona kanë aplikuar më përpara, ose kanë paraqitur interes për t'u punësuar dhe janë kontaktuar për këtë periudhë.

*Z. I. Celibashi:* Keni një listë ju të personave që në mënyrë të vazhdueshme kërkojnë punë në Bashkinë e Rrogozhinës me kohë të pjesshme, nuk po flas për procedurat e tjera të rekrutimit, por punëtorë krahu ose punëtor shërbimesh të ndryshme.


*Znj. E. Kacani, përfaqësuese e Bashkisë Rrogozhinë:* Përveç këtyre që janë këtu nuk kemi lista të tjera!

*Z. I. Celibashi:* Në rregull! Po, zoti Logu, pyetje tjetër!

*Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:* Mesa di unë, njerëzit kërkojnë punë tek zyra e punës, por gjithsesi le ta marrim që në Rrogozhinë kërkojnë në bashki. Në këtë dosje që keni ju, sa njerëz ishin në atë dosje? Sa ishte numri i qytetarëve që kishin ardhur në Bashkinë Rrogozhinë dhe kishin kërkuar punë?

*Znj. E. Kacani, përfaqësuese e Bashkisë Rrogozhinë:* Këtë nuk e kam si informacion se sa ka qenë numri.

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 15.03.2022*

*Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:* Në rregull, do na e sillni besoj në seancën tjetër. Dhe të lutem për këta 44 shtetas, të cilët ne kërkojmë informacion, a mund të na sillni të 44 kërkesat e tyre, apo 44 aplikimet që kanë bërë pranë Bashkisë Rrogozhinë për punë?

*Znj. E. Kacani, përfaqësuese e Bashkisë Rrogozhinë:* 44 personat, unë në fakt nuk e kam listën se kush janë 44 personat...

*Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:* Të paktën për ata 27 po themi që keni pranuar ju..

*Znj. E. Kacani, përfaqësuese e Bashkisë Rrogozhinë:* Për 27, po e kemi të gjithën.

*Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:* Na sillni kërkesat dhe aplikimet që ata kanë bërë pranë Bashkisë Rrogozhinë për punë dhe na sillni dosjen, na thoni sa është numri total i personave dhe ju lutem në qoftë se keni dokumente, shkresa të dhëna zyrtare, që provojnë si është realizuar procesi i rekrutimit na i vini në dispozicion. Pra, në qoftë se ka pasur dokumentim, se qoftë edhe kjo në administratë publike, mesa e njoh unë administratën, kur dikush merret në telefon dhe interesohet për një procedurë të caktuar, ndodh që mbahet dhe ndonjë procesverbal. Mund të ketë ndodhur që të jetë mbajtur ndonjë procesverbal i caktuar që u thirrën këta persona, u përgjigjën kaq, u bë kjo procedurë, etj, etj. Pra duam të kuptojmë procedurën e rekrutimit, kështu që çdo gjë që është me interes të procedurës së rekrutimit besoj që është me interes për ne. Faleminderit zoti Celibashi!

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 15.03.2022*

*Z. I. Celibashi:* Faleminderit! Kisha dhe një pyetje tjetër nga zoti Logu në lidhje me nëse keni dijeni tani për momentin për marrëdhëniet e dy personave në këtë listë me kryetarin në detyrë të bashkisë dhe kandidatin, keni dijeni?

*Znj. E. Kacani, përfaqësuese e Bashkisë Rrogozhinë:* Jo! Në dijeninë time nuk janë në lidhje miqësie.

*Z. I. Celibashi:* Janë me të njëjtin mbiemër më duket?

*Znj. E. Kacani, përfaqësuese e Bashkisë Rrogozhinë:* Gjysma e Rrogozhinës pak a shumë të njëjtat mbiemra ka, pak a shumë. Kështu që nuk mund të përgjigjem ekzakt, por që...

*Z. I. Celibashi:* Po gjysma tjetër?

*Znj. E. Kacani, përfaqësuese e Bashkisë Rrogozhinë:* Nuk kam informacion nëse kanë lidhje apo jo!

*Z. I. Celibashi:* Nuk e dimë këtë gjë. Dakord! Kemi ndonjë pyetje tjetër zoti Logu para se të vendosim? Mirë, atëherë duke e mbyllur për sot seancën, por duke e vazhduar për një ditë tjetër që ju do t'ju njoftohet zyrtarisht. Ndërkohë do duhet të sillni si informacion ato çfarë kërkoi përfaqësuesi i Partisë Demokratike në lidhje me procedurat e punësimit të këtyre personave, kopje të kontratës së punës edhe besoj në kopjet e kontratave të punës duhet të jenë dhe pushimet e punës për gjithsecilin, besoj. Dakord, jemi të qartë? Mirë, faleminderit, seanca mbyllet! Seanca tjetër do të njoftohet zyrtarisht me email. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*

